



DITARI MUJOR

Mars 2024

LAlA - Labororët e Inteligjencës Artificiale në Shqipëri dhe Kosovë

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", mori pjesë në takimin e parë të projektit "Laboratorët e Inteligjencës Artificiale në Shqipëri dhe Kosovë - LAlA" në Universitetin e Pireut në Greqi, të cilët janë edhe liderët e projektit. Ky projekt, financuar nga Programi Erasmus+ KA2 CBHE i Bashkimit Evropian, ka bashkuar universitete të ndryshme nga Shqipëria, Kosova, Greqia dhe Danimarka me synimin e krijimit të kurrikulave të nivelit master në fushën e inteligjencës artificiale në rajon duke mundësuar formimin e ekspertëve të inteligjencës artificiale. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" është shpresëplotë në impaktin pozitiv që do të ketë ky projekt në forcimin e kapaciteteve arsimore, për të qenë bashkëkohor me kërkesat e tregut ndërkombëtar, si edhe me zhvillimin e teknologjisë.



Seminari i Parë Kombëtar HERE në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"



Në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", u organizua për dy ditë rradhazi Seminari i Parë Kombëtar HERE nga grupi i ekspertëve HERE, Zyra Kombëtare Erasmus+ dhe SPHERE, me pjesëmarrjen e veçantë të ekspertit Prof.dr. Liviu Matei MAE. Në fokus të këtij takimi ishin çështjet kyçe që lidhen me procesin e ndërkombëtarizimit në arsimin e lartë. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", prej vitesh ka në qendër të strategjisë institucionale zhvillimin e ndërkombëtarizimit, përmes programeve të shkëmbimit, bashkëpunimit me universitetet e tjera partnere, pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, organizimin e konferencave dhe aktiviteteve ndërkombëtare, duke forcuar kështu lidhjet me institucionet e tjera në botë.

Takim mbi projektin 'COST -CLIL Network for Languages in Education'

Nga data 4-6 Mars 2024 u zhvillua në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", takimi i grupit drejtues dhe grupeve të punës të projektit CA21114 - CLIL Network for Languages in Education : Towards bi- and multilingual disciplinary literacies (CLILNetLE), një projekt i COST Association, financuar nga Komisioni Evropian. Gjatë këtyre ditëve ekspertë të fushës së shumëgjuhësisë nga 16 vende të ndryshme punuan për të përmbushur objektivat e projektit i cili është në vitin e tij të dytë. Personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Humane ka dhënë kontribut të rëndësishëm në kërkimin shkencor si pjesë e këtij COST Action.



Klubi Studentor i Vullnetarëve në Universitetin e Elbasanit

Vetëm pak kohë nga ngritja e Klubit Studentor të Vullnetarëve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", ka nisur iniciativa e parë e tyre, duke bërë një vizitë të veçantë në maternitetin dhe pediatri të Spitalit të Elbasanit. Studentët shpërndanë verore të bashkëngjitura me thënie dhe mesazhe të ndryshme, duke përcjellë emocione të paharrueshme për më të vegjlit në Ditën e Verës.





Universiteti Elbasanit në Panairin Work & Study 2024

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", merr pjesë në Panairin Work & Study 2024, duke ndarë mundësi dhe rrugë të reja për maturantët e Elbasanit. Zyra e Këshillimit të Karrierës, personeli akademik dhe studentët, kanë ofruar informacion të rëndësishëm për programet e studimit, programet e shkëmbimeve ndërkombëtare, mundësitë e praktikave profesionale dhe hapësirat e dedikuara për zhvillimin e tyre akademik, profesional dhe kulturor. Gjithashtu, maturantët që kanë vizituar stendën e universitetit kanë pasur rastin të dëgjojnë nga përvojat e suksesshme të studentëve aktualë dhe të të diplomuarve. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të këshillimit të karrierës, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, IAL, Dhomën e Tregtisë Tiranë, ZVAP Elbasan dhe Bashkinë Elbasan.

Tryeza Shkencore "Hasan Prishtina ideologu i lëvizjes për bashkimin kombëtar të shqiptarëve"



Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Departamenti i Histori-Gjeografisë në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhësisë, si edhe me Fondacionin "Hasan Prishtina", Institutin e Studimeve Sociale e Humane pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", organizuan tryezën shkencore me titull: "Hasan Prishtina ideologu i lëvizjes për bashkimin kombëtar të shqiptarëve". Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës u prezantua si fillim nga Z. Mehmet Prishtina në ekspozitën e paraqitur në hollin e bibliotekës së universitetit me dokumente të ndryshme nga AQSH, duke vijuar më pas me kumtesat e pjesëmarrësve. Pjesëmarrës në këtë tryezë shkencore ishin personeli akademik dhe studentë të të tria cikleve nga Fakulteti i Shkencave Humane, si edhe përfaqësues të familjeve të rilindasve shqiptarë.

Gjimnazistë të shkollës "Dhaskal Todri", vizituan Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"



Një grup nxënësish të klasës së 11-të të gjimnazit "Dhaskal Todri", vizituan Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani". Fillimisht, nxënësit të shoqëruar nga mësuesja e tyre, znj. Manjola Tahiraj, u pritën nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit ku u informuan rreth fakulteteve përbërëse dhe rreth programeve të studimit që UE ofron, u njohën më nga afër me zyrën e karrierës dhe rëndësinë që ajo ka për jetën studentore, për mundësinë që u ofron studentëve në zhvillimin e praktikave profesionale dhe krijimin e kontakteve me bizneset e partnerët të tjerë për të mundësuar punësimin e tyre. Gjithashtu gjimnazistët u informuan rreth programit Erasmus+ dhe internshipëve studentore, për marrëveshjet e bashkëpunimit që UE ka me institucione të ndryshme etj. Të drejtuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, realizuan një guidë në ambientet e Korpusit Qëndror të Universitetit ku vizituan laboratorë të ndryshëm, Amfiteatrin, duke u ndalur në fund te Biblioteka e Universitetit.



Sesion Informues në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore Startup Albania

Agjencia Shtetërore Startup Albania në bashkëpunim me Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" organizuan sesionin informues për studentët dhe personelin akademik për mundësinë e financimit të ideve inovatore nëpërmjet Masave Mbështetëse me Grante për startup-e. Përfaqësues të këtij institucioni, i prezantuan studentët me thirrjen për përfitimin e granteve dhe masave mbështetëse, fondin e vënë në dispozicion, kriteret, fazat, procedurat, afatet etj. Agjencia Shtetërore Startup Albania do të mbështeti zhvillimin e startup-ve shqiptare duke financuar individë privatë, nomadë digjital, kompani të regjistruara, studentë e personel akademik që kanë ide inovatore.

Tryezë shkencore në UNIEL



Universiteti i Elbasanit, Departamenti i Gjuhësisë në bashkëpunim me Departamentin e Gjuhës dhe Kulturës Sllave dhe lektoratin e shqipes si pjesë e projektit seeFField në Universitetin e Resensburgut, organizuan bashkëpunimin e parë shkencor në Universitetin e Elbasanit, si shkëmbim të përvojave studimore për një nga çështjet e rëndësishme të realitetit gjuhësor në shek.XXI. Pjesë e kësaj tryeze ishin personeli akademik i Fakultetit të Shkencave Humane, Departamentit të Gjuhësisë dhe Departamentit të Gjuhëve të Huaja, si edhe studentët e programeve të studimit të këtyre departamenteve të tre cikleve.

Klubi Studentor Vullnetari në UNIEL



Studentët e Klubit Studentor Vullnetari në Universitetin e Elbasanit i bashkohen nismës për dhurimin e gjakut. Në një përpjekje të frymëzuar nga humanizmi dhe dëshira për të ndikuar pozitivisht në shoqërinë tonë, studentët e Klubit Studentor Vullnetari i janë bashkuar nismës për të dhuruar gjak për fëmijët talasemikë.